



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosova

AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT
AGENCIJA PROTIV KORRUPCIJE
ANTI - CORRUPTION AGENCY

DATË/A:	07/08/2014
REFERENC-Ë:	AKK-DPKPP
PËR/ZA/TO:	z. Gazmend RUSHITI Shef i Prokurimit në Qendrën Klinike Universitare të Kosovës
CC:	z. Curr GJOCAJ Drejtor i Përgjithshëm i Shërbimit Spitalor Klinik Universitar të Kosovës
NGA/OD/FROM:	z. Hasan PRETENI Drejtor i Agjencisë kundër Korrupsionit
TEMA/SUBJEKAT/SUBJECT:	Opinion lidhur me Tenderin: "Servisimi i Pajisjeve Radiologjike"



Të nderuar,

Duke u bazuar në nenin 5 paragrafi 1 nën paragrafi 1.12 të Ligjit për Agjencinë kundër Korrupsionit nr.03/L-159 dhe nenin 19 paragrafi 1, nën paragrafi 1.6 të Ligjit për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në Ushtrimin e Funkcionit Publik, lidhur me tenderin: "Servisimi i Pajisjeve Radiologjike" me numër prokurimi: 701-14-049-211, Agjencia kundër Korrupsionit ofron këtë:

OPINION

Kërkohet nga ju si autoritet kontraktues, që t'i ndërmerrni të gjitha veprimet e nevojshme drejt evitimit të shkeljeve të evidentuara në lidhje me tenderin: "Servisimi i Pajisjeve Radiologjike", në mënyrë që të respektohen dispozitat përkatëse të Ligjit nr.04 – L/042 për Prokurimin Publik.

A r s y e t i m

Qendra Klinike Universitare e Kosovës - QKUK, bazuar në nevojën e Servisimit dhe Mirëmbajtjen e Pajisjeve Radiologjike ka paraparë procedurë të hapur Prokurimi me titull: "Servisimi i Pajisjeve Radiologjike" Aktivitet të cilin, Qendra Klinike Universitare e Kosovës nuk ka mund ta finalizoj që nga viti 2012.

Kronologjia e aktivitetit të prokurimit për Servisimin e Pajisjeve Radiologjike sipas KRPP-së është si në vijim: Njoftim për Kontratë (19/04/2012); Njoftim për Dhënien e Kontratës (29/05/2012); Njoftim për Kontratë (08/06/2012); Njoftim për Kontratë-vazhdim afati (13/06/2012); Njoftim Anulimi (14/09/2012); Njoftim për Kontratë (19/12/2012); Njoftim Anulimi (05/03/2013); Njoftim për Kontratë (20/05/2013); Njoftim për Kontratë (28/06/2013); Njoftim për Kontratë - vazhdim afati (17/07/2013); Njoftim Anulimi (12/09/2013); Njoftim për Kontratë (03/04/2014); Njoftim për Dhënien e Kontratës (04/06/2014), dhe Njoftim për Dhënien e Kontratës(14/07/2014)

Agjencia Kundër Korrupsion ka ofruar Opinione për këtë lëndë më datë 15/08/2012 si dhe 21/10/2013. Autoriteti Kontraktues, Qendra Klinike Universitare e Kosovës ka respektuar Opinionet e Agjencisë me ndërprerje të aktivitetit, mirëpo prapë se prapë Autoriteti Kontraktues nuk ka përgatitur një dosje të përshtatshme për përfundimin këtij prokurimi tejet kompleks. Kriteret e domosdoshme dhe të qarta mund të inkorporohen në Dosjen e Tenderit dhe njëherë e përgjithmonë ti jepet fund një procesi i cili duhet të jetë i drejtë dhe transparent.

Më datë 03/04/2014 Qendra Klinike Universitare e Kosovës ka shpallur sërish në KRPP Njoftim për Kontratë për aktivitetin e prokurimit Servisimi i Pajisjeve Radiologjike. Agjencia Kundër Korrupsionit ka identifikuar këtë aktivitet Prokurimi si rast për trajtim dhe gjatë ekzaminimit të aktivitetit të prokurimit nga "Dosja e Tenderit", Agjencia Kundër Korrupsionit ka hasur në disa të dhëna që nuk janë në përputhje të plotë me Procedurat e Prokurimit në Kosovë.

Në Seksioni II. FLETA E TË DHENAVE TË Tenderit (FTD), rubrika Kërkesat mbi mundësitë teknike dhe/ose profesionale, pika 9.2 Dëshmia e kërkuar dokumentare, tek nënpika 1, kërkohet: Minimum Tre serviser të certifikuar nga prodhuesi (Të dëshmohet me Certifikatë, kontratë pune si dhe Dëshmi nga ATK për pagesën e kontributeve për serviserët nga ofertuesi, minimumi 12 muajt e fundit). Autoriteti Kontraktues me këtë kërkesë nuk i ka dhënë mundësinë konkurrencës së lirë duke kufizuar mundësinë që grupi i Operatorëve Ekonomik ta plotësoj njëri tjetrin në pajtim me ligjin e prokurimit në Kosovë.

Njësia e kërkesës nga Reparti i Radiologjisë pran QKUK-së i ka propozuar me një dokument (të datës 11/02/2014) zyrës së prokurimit tre kriteret Teknike Profesionale për këtë Tender, të cilat kriteret zyra e prokurimit i ka vendosur në Dosjen e Tenderit. Njësia e kërkesës, në këtë rast Reparti i Radiologjisë është përgjegjëse vetëm për specifikimin teknik për shërbimin që kërkon. Në asnjë rast nuk mund të përcaktoj kriteret teknike dhe profesionale. Përgjegjëse për procedurat e prokurimit përfshirë edhe kriteret teknike dhe profesionale, është zyra e prokurimit.

Njoftimi për Kontratë për këtë aktivitet të prokurimit është shpallur më datë 03/04/2014 ndërsa Raporti i Vlerësimit është përgatitur më datë 26/05/2014. Në raportin e vlerësimit konstatohet se vetëm njëri nga tre Operatorët Ekonomik është i përgjegjshëm. Pas këtij konstatimi, Qendra Klinike Universitare e Kosovës, ka njoftuar KRPP-në më 30/05/2014 që Autoriteti Kontraktues do të vazhdoj procedurën me Operatorin e vetëm të Përgjegjshëm Ekonomik.

Më datë 04/06/2014 Qendra Klinike Universitare e Kosovës ka bërë Njoftim për Dhënie të Kontratës në faqen e KRPP-së, me të cilin Njofton se Operatori Ekonomik "Medica" është zgjedhur për tu shpërblyer me Kontratën në fjalë.

Për të shfaqur mospajtimet e veta, dy nga operatorët ekonomik që ishin cilësuar si të pa përgjegjshëm nga Qendra Klinike Universitare e Kosovës kanë paraqitur ankesë në OSHP. Njëri më datë 06/06/2014 (169/14), ndërsa tjetri më 09/06/2014 (171/14). Ankesat e Operatorëve Ekonomik janë shqyrtuar nga OSHP dhe me këtë rast, njëra është aprovuar pjesërisht ndërsa tjetra është aprovuar në tërësi. Me Vendimin 169/14 , 171/14 të datës 07/07/2014 Organi Shqyrtues i Prokurimit ka anuluar "Njoftimin për Dhënie të Kontratës" dhe kthen lëndën me nr. prokurimi 701/14/049/211 në Rivlerësim.

Pas rivlerësimit të ofertave, në Raportin e Rivlerësimit të datës 08/07/2014 del si fitues Operatori Ekonomik Ledi Med. Pra, në Njoftim për Dhënie të Kontratës të datës 14/07/2014 në KRPP, Autoriteti Kontraktues, ka vendosur që për herën e dytë, ta shpërblej me kontratë Operatorin tjetër Ekonomik (Ledi Med), i cili në raportin e vlerësimit të parë nuk ishte cilësuar si i përgjegjshëm.

Në këtë Aktivitet prokurimi, Qendra Klinike Universitare e Kosovës nuk ka kërkuar Autorizim nga Prodhuesi për pajisjet radiologjike. Ky veprim i Autoritetit bie në kundërshtim Opinionin e Agjencisë si dhe me Konkluzionin e OSHP-se me nr PSH. nr. 183/2013 të datës 26/06/2013 ku thuhet, citoj: URDHEROHET Autoriteti Kontraktues QKUK që për çdo LOT të kërkoj autorizim nga prodhues, për aktivitetin e prokurimit "Servisimi dhe mirëmbajtja e pajisjeve radiologjike për Qendrën Diagnostike dhe Institutin e Onkologjisë"

Agjencia Kundër Korrupsion ka përcjellë me vëmendje të shtuar këtë aktivitet prokurimi dhe cilëson se si i tillë është mjaftë kompleks dhe duhet të zgjidhet në kohë të arsyeshme. Agjencia rekomandon që njëherë e përgjithmonë ti jepet zgjidhje kësaj çështje pasi që bëhet fjalë për interes të gjerë të qytetarëve të Kosovës.

Agjencia gjithashtu Rekomandon që të gjenden modalitete që servisimi dhe mirëmbajtja e pajisjeve radiologjike të bëhet me pjesë origjinale dhe me shërbim profesional të autorizuar nga prodhuesi në mënyrë që mos të dalin probleme të tjera gjatë ekzekutimit të kontratës.

Konsiderojmë se veprimet e Autoritetit Kontraktues bien ndesh me Nenin 7 Barazia në Trajtim/ Jo-Diskriminimi; nenin 27 Dosja e Tenderit; nenin 28 Specifikimet Teknike; si dhe nenin 71, Grupet e Operatorëve Ekonomik dhe Operatorët e Huaj Ekonomik të Ligjit për Prokurimin Publik Nr.04/L-042

Agjencia Kundër Korrupsion konsideron se praktika të tilla nuk duhet lejuar, andaj rekomandon anulimin e këtij aktiviteti, duke mos i përsëritur praktikat e ngjashme në të ardhmen.

Autoritetet Kontraktuese e informojnë Agjencinë për veprimet e ndërmarra.

Me respekt!